



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 01

Prishtinë, më 22.03.2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj - Beqaj,
Biserka Kostiq, Justina Shiroka - Pula, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kymete Bajraktari
dhe Duda Balje.

Mungoi: Ismet Beqiri.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi – OSBE, Lejla Selimi- OSBE, Natyra Kasumaj- KDI
dhe Agon Vrenezi- OHCHR.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator, Sulltane Gashi-
zyrtare ligjore dhe Burim Tahiri- praktikant.

Mbledhjen e drejtoi: Suzana Novoberdaliu- kryetare.

Suzana Novoberdaliu konstatoi se në bazë të Rregullores të Kuvendit të Republikës së
Kosovës janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Mbledhjen e kryesoi Suzana Novobërdaliu, kryetare dhe propozoi këtë

R e n d d i t e:

- 1. Mbledhja konstituive e Komisionit,**
- 2. Të ndryshme.**

U hap shqyrtimi për pikën e parë.

1. Mbledhja konstituive e Komisionit

Suzana Novoberdaliu, kryetare - I përshëndeti anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit që e monitorojnë punën e tij; shoqërinë civile, mediat, si dhe stafin mbështetës duke iu dëshiruar bashkëpunim dhe punë të mbarë.

Ajo tha se nga titulli i Komisionit keni vërejtur se cilat fusha të veprimit përfshin Komisioni, kështu që fushëveprimtaria e tij bazohet në këto fusha: të drejtat e njeriut, barazia gjinore, personat e pagjetur dhe peticione dhe asnjërën nuk mund ta veçojmë ose t'i japim prioritet me shumë se tjetrës, sepse secila e ka rëndësinë e vet të veçantë.

Meqenëse kjo është mbledhja konstituive, ajo kërkoi nga anëtarët e Komisionit të bëjnë prezantimin e tyre subjektet që i përfaqësojnë, si dhe profesionin e tyre, kështu që do ta kemi më të lehtë angazhimin e secilit në fushën përkatëse dhe që të gjithë të jepni kontributin maksimal, aty ku mundeni.

Në vazhdim kryetarja tha se gjatë punës së Komisionit të gjithë anëtarët e tij do të jenë të barabartë. Prandaj kërkoi nga anëtarët, që në pika të shkurtra, të bëjnë një prezantim të shkurtër rreth biografisë së tyre.

Rita Hajzeraj - Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje prezantuan biografitë e tyre dhe e admiruan punën e Komisionit.

Kryetarja vuri në dukje se në mbledhjen e radhës, që do të mbahet më 29 mars 2011, nëse të gjithë pajtohen të ftohet ushtruesja e detyrës, zonja Shqipe Krasniqi, nga Agjencia për barazi gjinore, me qëllim që të informohemi për së afërmi se çka është duke u bërë në lidhje me Ligjin për barazinë gjinore, si dhe për problemet me të cilat ballafaqohet Agjencia.

Ishte konstatim unanim që lidhur me mbledhjen e radhës së Komisionit të nxirret ky

Përfundim

Komisioni vendosi që më 29. 3. 2011 të ftohet Shqipe Krasniqi nga Agjencia për barazi gjinore, që të informohen për së afërmi lidhur me monitorimin e Ligjit për barazi gjinore dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen.

Te ndryshme

Kryetarja i njoftoi anëtarët lidhur me dy peticionet që duhet të shqyrtohen.

Në këtë pikë u fol edhe për funksionin e këtij komisioni, si dhe për mbledhjet e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzana Novoberdaliu

